



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:020667

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474673

**NË EMËR TË POPULLIT**

**P.nr../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL,** gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrjen të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati në çështjen penale ndaj të pandehurit A.. B.. për shkak të veprës penale vjedhje e rende nga neni 315 par 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme sipas aktakuzës PP/II.nr.871/19 të datës 08.07.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun me datë 05.02.2024, dhe 27.02.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Ardiana Veseli, të pandehurit A.. B.. dhe mbrojtësi i tije av Gani Kelmendi sipas detyrës zyrtare , të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 19.03.2024 përpiloi këtë:

**A K G J Y K I M**

**Për të pandehurin,**

**A.. B..**, i lindur më datë ..... në P.., me vendbanim në Rr. "R.." nr..., P.., i biri i L.. dhe nënës Z.. e vajzërisë H.., ka të kryer shkollën fillore, i pa punë i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr....., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet ne liri.

Konform nenit 362 par.1 nën par 1.1 të KPP-së

**REFUZOHET AKTAKUZA**

**Gjëja se:**

**I pandehuri A.. B..**

Me datë 14/04/2019, rreth orës 08:00, në lokalitë 90-Bar, në rr. "T.. B.." P.., të pandehurit me dashje dhe në bashkëveprim me NN/ persona të paidentifikuar si dhe me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme për vete marrin pasurinë e të dëmtuarit A.. S.., në atë mënyrë që: ditën kritike pas planifikimit të të pandehurve, shkojnë në vendin e sipërsëhënuar dhe atë me automjetin e Ilojit AUDI ngjyrë të zezë me targa 01-668-IL tek lokali ne fjalë, ku me mjet të fortë-kaçavidë

i pandehuri A.. B.. hapë derën kryesore të lokalit ku të gjithë së bashku hynë në lokal dhe nga aty marrin 5 televizor, 3 telepilot, 1- drinbox, dhe me pas me shpejtësi me veturën e sipërshënuar pronë të pandehurit B.. K.., i cili i priste në veturë largohen nga vendi i ngjarjes.

-me çka kishte për të kryer veprën penale vjedhje e rende nga neni 315 par 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I dëmtuari A.. S.., rr K.. R.. K.. P.., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civilë.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm me datën 08.07.2019, ka ngritë aktakuzën PP/II.nr.871/19, ndaj të pandehurit A.. B.. për shkak të veprës penale vjedhje e rende nga neni 315 par 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën shqyrtimit kryesor të hapur për publikun me datë 05.02.2024, dhe 27.02.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Ardiana Veseli, të pandehurit A.. B.. dhe mbrojtësi i tije av Gani Kelmendi.

Pas shqyrtimit të provave ne fjalën përfundimtare Prokurorja e Shtetit Ardiana Veseli është tërhequr nga akuza ndaj të pandehurit duke deklaruar se: Ne mbështetje te nenit 351 par.1 te Kodit te Procedurës Penale paraqes pranë kësaj gjykate fjalën përfundimtare sipas aktakuzës PP/II nr. 871/2019 te datës 08.07.2019, kundër te pandehurit A.. B.. për shkak te veprës penale "Vjedhje e rënd, ne bashkëkryerje nga neni 315 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-së. Për te pandehurit B.. K.. dhe D.. Sh.. është veçuar procedura penale dhe gjykata ka marr aktgjykim dënues. Nuk është kontestues fakti se me date 14.04.2019 rreth orës 18:00 ne lokalin 90-Bar, ku te pandehurit me dashje dhe ne bashkëveprim me qellim te përvetësimit te pasurisë se luajtshme për vete marrin pasurinë e te dëmtuarit A.. S.. dhe atë 5 televizor, 3 tel pilot, 1- drinbox, e te cilat sende me vone gjenden te fshehura ne një lokacion ne shatin K.. ne P.., te cilat i kthehen pronarit. Policia me ane te plotësimit te kallëzimit penal njofton prokurorinë lidhur me Procesin mbi identifikimin e personave përmes fotografive, ku ne atë proces është identifikuar nga te bashkëpandehurit këtu A.. B.., si kryes i kësaj vere penale. Nga ana e policisë nga Njësi i forenzikes nuk është arritur te sigurohet edhe ndonjë prove tjetër materiale pas ekspertizave e qe do te mund te krahasoheshin gjurmët e vijave papilare, këtu i pandehuri A.. B.., e mohon kryerjen e kësaj vere apo pjesëmarrjen ne çfarëdo forme duke mbetur vetëm tek identifikimi përmes fotografive nga te bashkëpandehurit te cilët me vendbanim ishin nga P... Andaj, bazuar ne nenin 119 par.5 te KPPRK-se, deklaratat e te pandehurit te dhuna ne çfarëdo konteksti me vullnet dhe pa shtrëngim, nuk mund te shërbejnë si prove ndaj te bashkëpandehurve ne te njëjtën procedure penale apo edhe ne procedurën e veçuar. Nga te lartcekurat e ne mungese te provave qe do te vërtetonin dyshimin e bazuar mire se këtu i pandehuri me veprimet e tij te ketë kryer

verën e lartcekur penale, kemi vendosur qe te tërhiqemi nga ndjekja penale ndaj te pandehurit A.. B...

Gjykata në kuptim të nenit 362 par.1 nën par 1.1 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke refuzuar aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.871/19 të datës 08.07.2019 të paraqitur ndaj pandehurit, A.. B.. për shkak të veprës penale vjedhje e rende nga neni 315 par 1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale, bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 453 par.1 të KPPK-së.

Konform nenit 452 të KPP-se, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën e udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 362 par 1 nën par 1.1 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**  
**2020:020667, 19.03.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

\_\_\_\_\_  
**Edona Berisha Kastrati**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**

\_\_\_\_\_  
**Musë Povataj**

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.